# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7568 E shtunë 23 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

KORÇA BEER edhe sot me e mira...

KORÇA BEER edhe sot me e mira...

Dje në "Deutsche Welle"

Nga FEILCKE, WAGENER

## A mund ta shpëtojë Shqipëria Merkelin si kancelare?



Askush nuk i konfirmon fjalët në qarkullim: Shqipëria mund të bëhet një vend kyç për pritjen e përkohshme të refugjatëve në Europë, por jo në BE. Një zgjidhje e artë kjo... Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga NAMIK KOPLIKU

## Shqipëria duhet të qëndrojë në anën e drejtë të historisë

Populli shqiptar përjeton demokracinë pas rrëzimit të diktaturës në vendin e tij. Aktualisht Shqipëria është në përpjekje të vazhdueshme për t'u bashkuar me... Vijon në faqen 21

VENDIMI I QEVERISE/ LISTA E FAMILJEVE QE PERFITOJNE PRONESINE E TERRENIT KU KANE NDERTUAR

# LEGALIZIMET, 300 EMRAT QE MARRIN TAPINE E TOKES

Ndërtimet pa leje në tokë private dhe në tokën e shtetit, ja kush janë individët që marrin tapinë e tokës në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër, etj.



*(Në foto)* Foto ilustruese

Në faqen 9



"Pakti me Greqinë do të jetë i drejtë"

## Rama: Dritë jeshile më 28 qershor, nuk na kërkoi njeri të marrim refugjatë

Tri partitë qeverisëse në Gjermani: Mbështetje me kushte Shqipërisë: Krijoni SPAK-un

Grupet parlamentare të partive të koalicionit CDU/CSU e SPD kanë formuluar qëndrimin ndaj një nisjeje të negociatave të anëtarësimit në BE me Shqipërinë. Nisja e negociatave mbështetet, por me një sërë kushtesh. Kancelarja e Gjermanisë Angela Merkel do ta informojë të enjten në një deklaratë qeveritare Bundestagun...

Në faqet 2-3

FLASIN TE RINJTE

### Karta rinore, mbetet peng i neglizhencës së institucioneve

Në faqen 6

KUSH PERJASHTOHET

### Projektligji, të vrarët e 21 janarit marrin statusin e dëshmorit

Në faqen 4

DOKUMENTACIONI

### Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Në faqet 10-11

FITON ZVICRA 2 ME 1



### Xhaka e Shaqiri i presin biletën Serbisë, mediat: Provokacija!

Në faqen 22

BLUE TOOTH

Aurela Gaçe, pushime me familjen. Ja lëvizjet e fundit nëpër televizione

## Fotot çift, Afërdita Dreshaj "prezanton" burrin hokeist

*Meta fton sportistët e njohur në Presidencë, festojnë në mbrëmje me shenjën e shqiponjës*

Nga PAMELA ALIAJ

Edhe pak ditë dhe do të kemi mundësinë, edhe pse nga larg, të shijojmë dasmën e parë madhështore për këtë verë të VIP-ave tanë. Në fund të këtij muaji, këngëtarja dhe modelja shqiptare do të kurorëzojë





dashurinë me hokeistin çek Jakub Kindl. Përgatitjet për natën e tyre më të rëndësishme kanë nisur herët dhe momente të tilla i kemi parë nga dyshja nëpërmjet publikimit të disa imazheve në rrjete sociale. Dhe së fundmi ata kanë realizuar...

Suplement

KULTURE

### Vula e Luigjit të Francës në veprën e sapozbuluar të Marin Barletit

Në faqen 12

# INTEGRIMI
## REAGIMET

### Zbardhen 9 kërkesat: Të përfundojë rivlerësimi i 57 gjykatësve e prokurorëve

# Tri partitë qeverisëse në Gjermani: Mbështetje me kushte Shqipërisë në BE

### "Të krijohet SPAK, të vijojë lufta ndaj kriminalitetit e drogës"



Grupet parlamentare të partive të koalicionit CDU/CSU e SPD kanë formuluar qëndrimin ndaj një nisjeje të negociatave të anëtarësimit në BE me Shqipërinë. Nisja e negociatave mbështetet, por me një sërë kushtesh. Kancelarja e Gjermanisë Angela Merkel do ta informojë të enjten në një deklaratë qeveritare Bundestagun për samitin e 28 dhe 29 qershorit të BE. Në këtë samit do të kërkohet konsensus për reformën e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (GEAS) dhe veçanërisht për direktivën Dublin III. Në samit do të flitet edhe për nisjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë me BE. Qeveria gjermane është shprehur në mbështetje të vendimit të Komisionit Evropian për të çelur negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë e Maqedoninë. Në projektrezolutën përkatëse të përgatitur Bundestagu e mbështet qeverinë.

**DRITË DHE HIJE NË PËRPARIME**

Në projektrezolutën për Shqipërinë, Bundestagu e mbështet perspektivën e Shqipërisë për në BE dhe "vlerëson përpjekjet për reforma të Shqipërisë". "Gjermania dhe BE kanë interes të veçantë për stabilizimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në rajon", shkruhet në projektrezolutë. "Zbatimi i reformës së gjerë në drejtësi ka nisur", vetingu "po jep rezultate konkrete". Po të zbatohet me sukses kjo procedurë "Shqipëria do të jepte një kontribut të pashembullt paraprak". Rëndësi të veçantë merr edhe vazhdimi i ngritjes së autoritetit për luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar (SPAK). Por njëkohësisht Bundestagu konstaton se, me gjithë sukseset, ka ende deficite. Në këtë kuadër projektrezoluta kujton rrethanën se "deri në mes të 2018-ës duhet ta kenë kaluar procesin e vetingut më shumë se gjysma e rasteve të përcaktuara si prioritare". Korrupsioni në të gjithë sistemin juridik vazhdon të jetë problem. "Përparime të ndjeshme janë bërë" në luftimin e "kultivimin dhe tregtinë me kanabis", konstaton Bundestagu. Në projektrezolutë konstatohet vazhdimi i parregullsive në administratën publike. Citohet i Ngarkuari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Shqipëri me shifrën 30 përqind të rasteve si punësime të kundërligjshme në administratën publike.

**KËRKESA SHTESË PËR REFORMËN E LIGJIT ZGJEDHOR**

Bundestagu konsideron "të nevojshme" zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIR-it dhe të Komisionit të Venecias të 2013 dhe 2015 për reformën e ligjit zgjedhor, "edhe nëse kjo nuk është pjesë e katalogut evropian të kërkesave". Në këtë sfond, Bundestagu gjerman është i pikëpamjes se vendimi për nisjen e negociatave me Shqipërinë duhet të merret vetëm me "kushte të formuluara qartë". Bundestagu shpreh dakordimin që qeveria gjermane "ta miratojë një vendim të Këshillit Evropian për nisjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE". Veç kësaj, në pikën 1 të projektrezolutës, Bundestagu i kërkon qeverisë që ta miratojë hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Këshillin Evropian vetëm:

a) nëse "konferenca e parë e anëtarësimit" zhvillohet kur qeveria gjermane të këtë "konstatuar plotësimin e këtyre kushteve nga Shqipëria":

- plotësimin e përfundimit të rivlerësimit të 57 gjykatësve dhe prokurorëve të gjykatave më të larta të përcaktuar si prioritarë në kuadër të vetingut dhe largimin nga shërbimi të personave me përfundime negative
- kur qeveria shqiptare të ketë paraqitur një ligj për një reformë të ligjit zgjedhor

b) konferenca e dytë e anëtarësimit të zhvillohet vetëm atëherë kur Këshilli të ketë konstatuar se janë plotësuar këto kushte:

- zbatimi i ligjit për reformën e nisur të ligjit zgjedhor
- të kenë nisur ndjekje penale për gjykatë e prokurorë të konstatuar në veting se kanë bërë shkelje penale
- të jetë angazhuar një strukturë speciale për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar (SPAK)
- të jenë shtuar përpjekjet për të garantuar funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të SPAK përmes pajisjes së tyre me numër të mjaftueshëm gjykatësish e prokurorësh të verifikuar
- të ketë përparime solide në luftimin e kriminalitetit dhe të korrupsionit në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe nëpunësit e lartë civilë dhe politikanët. Këtu bëjnë pjesë "hetime proaktive, ndjekje penale dhe dënime në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar"
- rezultate të prekshme në reformën e administratës...duke përfshirë edhe "verifikimin e punësimit të nëpunësve civilë të rangut të lartë dhe të drejtorëve"
- të vazhdojë me intensitet luftimin e tregtisë dhe të kultivimit të drogës në Shqipëri.

Në pikën 2, projektrezoluta e Bundestagut kërkon që "nëse Shqipëria pas hapjes së negociatave për anëtarësim e zvarrit, ndërpret ose e kthen mbrapsht plotësimin e detyrimeve, të ndalen negociatat e anëtarësimit". Ndërsa në pikën 3, projektrezoluta i kërkon qeverisë që të bëjë të qartë se Shqipëria duhet të ndërmarrë "përpjekje shtesë të konsiderueshme" për ta garantuar sundimin e ligjit dhe vazhdimin e vetingut. "Zbulimi dhe konfiskimi i mjeteve financiare në lidhje me korrupsionin" kërkohet shprehimisht në këtë kuadër.

**KAPITUJ QË TË SHOQËROJNË TË GJITHA NEGOCIATAT**

Bundestagu gjerman kërkon në pikën 4 të projektrezolutës për Shqipërinë që marrja me fushat me rëndësi qendrore "(para së gjithash kapitulli 23 Pushteti gjyqësor dhe të Drejtat Bazë, 24 Drejtësia, Liria dhe Siguria) "të kryhet që në fillim të negociatave dhe të përfundojë vetëm në mbyllje të negociatave". Planet e veprimit të propozuara nga Komisioni për këtë "të kenë afate dhe objektiva të qarta". Veç elementëve të përmendur më lart, në pikën 5 të projektrezolutës kërkohet që të mbeten "pikëreferndesa të negociatave" edhe "liria e mediave dhe e shtypit", "të drejtat e personave në nevojë për mbrojtje dhe e pjesëtarëve të minoriteteve", si dhe "një shoqëri e gjallë civile". Bundestagu kujton në pikën 6 të projektrezolutës se nuk duhet të ketë një anëtarësim automatik të Shqipërisë, "për shembull duke përmendur një datë anëtarësimi pa përfunduar negociatat". Ndërsa në pikën 7 Bundestagu i kërkon qeverisë gjermane që të luftojë që për "acquis communitaire" të miratohen "sa më pak dispozita kalimtare dhe përjashtime". Bundestagu kërkon në pikën 8 që qeveria gjermane të angazhohet që "Shqipëria t'i plotësojë që në procesin e anëtarësimit kërkesat e Paktit të Stabilitetit dhe të Rritjes së BE si dhe kriteret e stabilitetit të Marrëveshjes së Mastrihtit përpara se të anëtarësohet edhe zyrtarisht në bashkimin monetar". Së fundi, në pikën 9 Bundestagu kërkon që të informohet në vazhdimësi për stadin e negociatave dhe të përparimet e Shqipërisë drejt anëtarësimit të mos vlerësohen vetëm nga Komisioni, por "rregullisht edhe nga qeveria gjermane, duke angazhuar përfaqësitë diplomatike".

**VLAHUTIN**

"Është e pamundur për mua të them çfarë do të ndodhë në Këshill pasi do të vendosin 28 shtete. Vendimi final do të jepet aty dhe në fund të javës që vjen do të njihemi. Çfarë mund të them është se Komisioni Europian është i qartë dhe mendon se Shqipëria i ka përmbushur atë që është e nevojshme për çeljen e negociatave",- tha dje, Vlahutin.



## Vlahutin: Absurde, u legalizua deti, BE nuk negocion të drejtën e pronës



Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Tiranë, Romana Vlahutin theksoi dje, se duhet t'i jepet fund legalizimit të pronave në bregdet. "Çështja e të drejtës së pronës është e drejtë themelore e të drejtave të njeriut dhe si e tillë për Bashkimin Europian nuk negociohet. Kjo është arsyeja që në vlerësimet tona për Shqipërinë kjo është reflektuar shumë mirë", u shpreh Vlahutin dje, gjatë një aktiviteti mbi të drejtën e pronësisë dhe problemet e kësaj çështjeje në Shqipëri, organizuar nga Bashkimi Europian. "E kuptoj se ka njerëz që kanë legalizuar plazhe ranore, gurë si tokë bujqësore, madje arritën të legalizonin detin si tokë bujqësore dhe kjo është absurde",-tha Vlahutin në fjalën e saj, duke shprehur shqetësim për këtë pikë. "Ju kujtoj se në raportin e fundit të KE-së për Shqipërinë, për kapitullin e 23, që ka të bëjë me kapitullin e drejtësisë, dhe të drejtave themelore, Shqipëria duhet t'i kushtojë rëndësi me prioritet kthimit, kompensimit dhe regjistrimit të pronës", shtoi ajo. Sipas Vlahutin disa ligje shkaktuan kaos, si ligji i famshëm 7501, ligji i legalizimeve në 2006. Ajo shtoi abuzimet që janë bërë në këto vite, ndërsa tha se ka marrë shumë ankesa nga qytetarë. "Është urgjente që praktikat abuzive të së shkuarës duhen të ndalen. Dhe ndërtimet pa leje në bregdet nuk duhet të legalizohen më. Të vendosen gjoba ndaj atyre që kanë përfituar nga toka e të tjerëve",-theksoi ambasadorja e BE.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Tërndafile VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



**LULZIM BASHA**

"Kush dëgjon Edi Ramën të flasë për taksa më të ulëta, e di se ai gënjen paturpësisht! 97% e shqiptarëve paguajnë më shumë taksa. Me taksën e re të ndërtesës bizneset po paguajnë 2-4 herë më shtrenjtë. E vetmja zgjidhje për shpëtimin e çdokujt, që refuzon të grabitet nga qeveria dhe bashkia, është bashkimi me PD dhe alternativën tonë për taksat më të ulëta në rajon",-tha dje, Basha.



**Zbulohet zgjidhja në paktin Greqi-Shqipëri për çamët**

## Ministri grek: Nuk diskutuam për paktin, por për vendet skeptike

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias ka deklaruar se me homologun e vet shqiptar, Ditmir Bushati, nuk ka diskutuar mbi marrëveshjen e pritshme dypalëshe, por tema kryesore ka qenë përballimi i kundërshtimeve për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në. "Më shumë na preokupoi se si do të mbështesim qëndrimet shqiptare në bashkimin Europian, sepse ka një sërë kundërshtimesh nga disa shtete anëtare për hapjen e negociatave me "Maqedoninë e Veriut" dhe me Shqipërinë", tha Kotzias gjatë konferencës për shtyp. Por, ndërkaq mediat raportojnë se në marrëveshjen e arritur për paktin mes Greqisë dhe Shqipërisë është bërë një lëvizje për të kënaqur të dyja palët që edhe emri "Çamëri" të mos përdoret, por të kërkohet ndjesë për ato çfarë kanë ndodhur në të shkuarën. Një burim nga Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme i tha Report TV se pala shqiptare i ka kërkuar Athinës zyrtare që në tekstin final t'i shtohet një fjali, ku pala greke në një farë mënyre do të shpreh keqardhjen për ngjarje jo të këndshme që kanë ndodhur në të kaluarën dhe kanë nxitur urrejtje dhe shpërngulje të popullsisë nga trojet e tyre në zonën e Epirit. I njëjti burim saktësoi se kjo kërkesë e palës shqiptare është pranuar nga ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Kotzias. Mësohet po ashtu se dakordësinë për këtë pikë Kotzias ia ka transmetuar homologut Bushati. Në tekstin përfundimtar të marrëveshjes edhe nëse do të shmanget referimi për çështjen çame, do të ketë shprehje të keqardhjes për ngjarje të së kaluarës, të cilat kanë nxitur urrejtjen mes komuniteteve dhe pakicave që jetonin në Greqi, duke i detyruar të shpërngulen prej trojeve të tyre. Një fjali interesante që do të futet në marrëveshjen e pritshme thotë se: "Greqia po ashtu nxit të gjithë këta të shpërngulur që t'i drejtohen gjykatave për të rimarrë të drejtat e tyre si qytetarë grek".

### Kryeministri mohon lajmet për 600 mijë refugjatë: PD pasardhëse e Esad Toptanit

# Rama: Dritë jeshile më 28 qershor, nuk na kërkoi kush të mbledhim refugjatë

### "Marrëveshja me Greqinë e drejtë, do e shohin të gjithë"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama mohoi sërish dje, lajmet për ardhjen e 600 mijë refugjatëve sirianë në Shqipëri. Në një koment të tij në "Facebook", por edhe gjatë fjalimeve që pati në turin e llogaridhënies në Sarandë, Rama i cilësoi këto "fake news", ose lajme të rreme. Ai akuzoi opozitën si paasardhëse e Esad Pashë Toptanit që po synon të bllokojë negociatat me BE-në. "Edhe pse kush i bie ndesh Shqipërisë në parlamente të vendeve europiane, nuk sheh përtej hundës së vet e nuk ka asnjë lidhje me të vërtetat e vendit tonë, po thjesht bën politikë të brendshme duke përdorur Shqipërinë, deri në sekondën e fundit ne do të luftojmë me të gjitha fuqitë që, në një formë a një tjetër, drita e 28 qershorit të jetë jeshile. Por asgjë nuk e shlyen dot nga ky proces turpin e esadistëve të rinj të Shqipërisë. Të cilët kanë hapur thesin e farës së keqe e po përpiqen të mbjellin e rrisin së fundi Lajmin e Rremë të 600 mijë sirianëve të ISIS-it që do mësyjnë në Shqipëri, në këmbim të çeljes së negociatave",- u shpreh Rama. "E vërteta është se as teorikisht e jo me praktikisht, nuk ekzistojnë në asnjë pikë të planetit, jo 600 mijë ushtarë të ISIS-it që presin avionët për t'u nisur për në Shqipëri, po as 600 mijë refugjatë të zakonshëm që mund të mblidhen e të spostohen si të ishin robër lufte, drejt një vendi të vetëm, lëre pastaj drejt një vendi të vogël sa Shqipëria",-u shpreh Rama. "Që kjo histori është po aq e vërtetë sa ç'është e vërtetë që Babalja është një hero popullor i luftës kundër kriminalitetit, kjo nuk ka diskutim! Që as nuk e ka çuar askush nëpër mend të mbledhë 600 mijë refugjatë për t'i sjellë në Shqipëri, kjo nuk do as mend as kalem, po nga ana tjetër, është njëqind përqind e sigurtë se asnjëherë dhe askund, asnjeri nuk i ka kërkuar Shqipërisë, as zyrtarisht as me shaka, që të bëhet megapikë grumbullimi e refugjatëve të importuar nga tërë Europa", u shpreh Rama. "Lum Esad Pashë Toptani që pas 100 vjetësh vetmie të hidhur në varr, nuk është më pa pasardhës", e mbylli ai komentin e tij.




Kryeministri Edi Rama

**NEGOCIATAT ME GREQINË**

Kryeministri Edi Rama nga Saranda, ku zhvilloi një dëgjesë publike me pakicat kombëtare, komentoi marrëveshjen me Greqinë, të cilën e quajti një fitore për të dyja shtetet. "Marrëdhënia me Greqinë ka pasur ngërçet e veta. Marrëveshja do të jetë e drejtë, dhe do jetë e vizualizueshme për të gjithë në hartë. Do shohin me sytë e tyre jo me sytë e partive. Jo me sytë e atyre që amplifikojnë lajme të rreme. Kufiri siç ishte dhe kufiri që kemi. Do kemi mundësi të shohim qartësisht se kemi bërë marrëveshjen e duhur me vendin tonë, por edhe të shohim ç'mund të bëjnë këta të dëshpëruar, pa skuadër e pa lider, që të gjithë pafuqinë e tyre e kthejnë dita-ditës në një forcë të madhe të destruktimit",- tha më tej Rama.

**ANKESAT PËR PRONAT**

Kryeministri Rama vijoi llogaridhënien dje, në Himarë, ku mori një sërë ankesash edhe nga minoritarë. Ai deklaroi se janë bllokuar të gjitha pronat e marra në përdorim në shkelje të ligjit në të gjithë Bregun, duke i dhënë fund procesit të padrejtësisë me pronat. Një qytetare nga Himara tha se kishte problem me pronat, pasi babai i saj ishte i dënuar në vitin 1951 nga regjimi komunist, "duke shkruar në dosje si sabotim ekonomik dhe jo politik, dhe kështu ia sekuestruan të gjithë pasurinë". "Ndërkohë këtu do të hapet zyra përkatëse, do bëhet dhe një zyrë konsulence për trajtimin e problemit, por ne këto akte që janë në konflikte me njërijtetrin dhe që kanë dokumente më të vjetra nuk do i pranojmë. E rëndësishme është që e kemi ndaluar këtë proces padrejtësish, që i ka futur njerëzit në situata konfliktuale",- theksoi kryeministri Rama. Në bashkëbisedim me qytetarët e Himarës kryeministri Edi Rama ka premtuar se do dëmshpërblehen të gjithë ato ndërtesa që janë shembur dhe kanë pasur statusin juridik të regjistrimit hipotekor

## Zëdhënësi i qeverisë austriake: Bisedime me Shqipërinë për refugjatët

Qeveria austriake ka nisur bisedimet me qeverinë shqiptare për të ndërtuar kampin e pritjes së refugjatëve në vendin tonë. Deklarata është bërë nga zëdhënësi i qeverisë austriake Peter Launsky-Tieffenthal në përgjigje të Deutsche Welle. Në emailin e dërguar për prestigjiozen gjermane, zëdhënësi specifikon se emigrantët do të kthehen në vendin e tyre pas pritjes në këto qendra. "Emigrantët ilegalë pas aksioneve të shpëtimit, duhet të mbahen e të ushtrohet përkujdesje për ta në kufijtë e jashtëm të Europës, e më pas sa më shpejt të jetë e mundur, ata duhet të kthehen mbrapsht në vendet e tyre të origjinës. Nëse kjo gjë nuk do të ishte e mundur, atëherë atyre duhet t'u ofrohet strehim i përkohshëm në qendrat e refugjatëve në vende të treta të sigurta. Rreth ngritjes së një qendre për refugjatët ndërkohë po mbahen bisedime ndër të tjera edhe me Shqipërinë",-u shpreh Peter Launsky-Tieffenthal.



### Ruçi i shkruan Kadaresë: Në Olimpin e letrave e të shkencës

Kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi i ka dërguar një letër shkrimtarit të madh Ismail Kadare, pak ditë pasi ai mori çmimin e Karrierës së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2017. Në letrën e dërguar për të madhin Kadare, Ruçi vlerëson shkrimtarin për rolin dhe kontributin e madh, jo vetëm në historinë e letrave shqipe. "Rrallë herë ndodh në kohën e sotme që krijimtaria letrare e njohur botërisht, kontributi intelektual plot finesë, vepra e thellë studimore dhe akademike, identiteti dhe vizioni evropian, simbolet e vlerat kombëtare dhe dedikimi shqëror e qytetar të bashkohen në një individ të vetëm, si në rastin Tuaj"- shkruan Ruçi.

Zbardhet projektligji i qeverisë, kush përfiton dhe kush përjashtohet nga statusi i dëshmorit

# Të vrarët e 21 janarit marrin statusin e "Dëshmorit të Atdheut"

## *Dëshmorë, kush u vra për mbrojtjen e zgjedhjeve pas '90-ës*

Valentina Madani

Qeveria i ka dërguar parlamentit një projektligj të ri për statusin e "Dëshmorit të Atdheut". Ky projektligj aktualisht është në fazën e konsultimit publik dhe më pas do t'i kalojë për miratim Kuvendit të Shqipërisë. Një ndër ndryshimet që bie në sy në draftin e qeverisë është se statusin e "Dëshmorit të Atdheut" e përfitojnë shtetas shqiptarë të vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990. Kjo pikë përfshin pikërisht viktimat e 21 janarit 2011, të cilët gjatë protestës përpara Kryeministrisë humbën jetën, Ziver Veizi, Faik Myrtaj, Hekuran Deda dhe Aleks Nika. Gjithashtu, statusin e dëshmorit e përfitojnë shtetasit shqiptarë që janë ekzekutuar apo kanë vdekur në burgjet dhe kampet e përqendrimit nazifashiste, deri më 9 maj 1945, si dhe shtetasit shqiptarë, të cilët brenda 2 viteve nga dita e daljes nga burgjet apo kampet e përqendrimit nazifashistë kanë vdekur si pasojë e plagëve apo sëmundjeve të ndryshme të marra në këto vende; shtetasit shqiptarë, pjesëtarë të formacioneve ushtarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë rënë në luftën kundër pushtuesve nazifashistë jashtë kufijve shtetërorë, deri më 9 maj 1945. Statusin "Dëshmor i Atdheut" nuk e përfitojnë personat që janë dënuar me vendime gjykate të formës së prerë për krime kundër njerëzimit, për bashkëpunim me pushtuesit e vendit, për veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë, për vrasje me dashje, pas datës 9 maj 1945. Sipas projektligjit të qeverisë, në rrethin e familjarëve, për efekt shpërblimi, bëjnë pjesë bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare, në çastin e vdekjes së "Dëshmorit të Atdheut". Shpërblimi ndërpritet kur asnjëri nga familjarët nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni dhe kur bashkëshortja/bashkëshorti i ve i "Dëshmorit të Atdheut" martohet përsëri.


Faksimile e projektligjit për statusin e "Dëshmorit të Atdheut"

**STATUSI**

Statusin e "Dëshmorit e Atdheut" përfitojnë shtetasit shqiptarë të vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990.

## Kapri: Ligji i qeverisë përjashton nacionalistët e vrarë para '45-ës

Qeveria i ka dërguar parlamentit një ligj të ri për statusin e "Dëshmorit të Atdheut", status i cili do të përfitohet nga të vrarët pas datës 9 maj 1945. Studiuesi Erald Kapri shpreh kundërshtinë, duke shtuar se nga ligji përjashtohen nacionalistët e vrarë para datës së sipërpërmendur. "Mund të duket e pabesueshme por Musine Kokalari, Sabiha Kasimati e çdo martir që u sakrifikua nga komunizmi nuk mund të përfitojë statusin e dëshmorit. Asnjë nacionalist s'mund të jetë dëshmor, por çdo komunist po", - thotë ai. Ndonëse studiuesi Erald Kapri foli edhe për mundësinë e rikthimit të eshtrave të diktatorit Hoxha në Varrezat e Dëshmorëve, mësohet se një gjë e tillë nuk është e vërtetë, pasi as ai dhe as Mehmet Shehu apo figura të tjera të komunizmit nuk janë dëshmorë.

## Ligji, Koçi: S'lejon që anëtarët e byrosë të shpallen dëshmorë

Zv.Ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi reagoi dje duke i cilësuar spekulime, sipas të cilit projektligji për statusin e "Dëshmorit të Atdheut" lejon që anëtarët e byrosë politike të shpallen dëshmorë. Petro Koçi shkruan se ligji i ri shërben për të eliminuar padrejtësitë e bëra në kohën e Enver Hoxhës. "Projektligji për statusin e 'Dëshmorit të Atdheut' nuk lejon në mënyrë absolute që ndonjë anëtar i byrosë politike të shpallet dëshmor. Mendjetredhurit të merren me ndonjë punë tjetër! Nacionalistët e tipit babale t'i kërkojnë 'alarmet' në arkivat e tradhtisë balliste. Ligji i ri eliminon padrejtësitë e bëra në kohën e Enver Hoxhës, kur të rënët nga familje që pas çlirimit quheshin 'me biografi të keqe' nuk shpalleshin dëshmorë", shprehet z.Koçi.

### NENI 18/ FAMILJA E "DËSHMORIT TË ATDHEUT"

**1.** Familjet e "Dëshmorëve të Atdheut" gëzojnë nderim e përkrahje të veçantë nga shteti. Ato përfitojnë shpërblim financiar mujor, kriteret dhe masa e të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për financat.
**2.** Në rrethin e familjarëve, për efekt shpërblimi, bëjnë pjesë bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare, në çastin e vdekjes së "Dëshmorit të Atdheut".
**3.** Shpërblimi ndërpritet kur asnjëri nga familjarët nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni dhe kur bashkëshortja/bashkëshorti i ve i "Dëshmorit të Atdheut" martohet përsëri.
**4.** Shpërblimi familjar tërhiqet nga kryefamiljari i "Dëshmorit të Atdheut" ose në rast mosmarrëveshjeje, kur është më shumë se një person, nga secili, sipas pjesës që i përket.
5. Në familjen e "Dëshmorit të Atdheut", për efekt nderimi dhe mirënjohjeje, përfshihen bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat, prindërit e prindërve, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtra, mbesat dhe nipërit e dëshmorit.

### PROJEKTLIGJI PËR STATUSIN E DËSHMORIT TË ATDHEUT KRITERET PËR SHPALLJEN OSE NJOHJEN E STATUSIT "DËSHMOR I ATDHEUT"

**NENI 5**

**Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i Atdheut"**

"Dëshmorë të Atdheut" shpallen ose u njihet statusi, si të tillë:
**1.** Personave që kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare apo në përpjekje për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe, para 28 nëntorit 1912.
**2.** Shtetasve shqiptarë dhe të huaj, që kanë rënë në luftë për mbrojtjen e integritetit territorial, të lirisë dhe pavarësisë të Shqipërisë, si dhe për arsye të kundërshtimit të pushtimit të trojeve shqiptare nga ushtritë e huaja dhe të qëllimeve shoviniste të tyre, nga data 28 nëntor 1912 deri në 7 prill 1939.
**3.** Shtetasve shqiptarë që kanë humbur jetën në mbrojtje të vlerave kombëtare dhe patriotike, të kombit shqiptar, para 7 prillit 1939.
**4.** Shtetasve shqiptarë që kanë marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, nga 7 prilli 1939 deri më 9 maj 1945.
**5.** Shtetasve shqiptarë të pushkatuar për pjesëmarrjen në formacionet luftarake të LANÇ apo për mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si dhe të pushkatuar për hakmarrje nga pushtuesit nazifashistë apo bashkëpunëtorët e tyre, nga data 7 prill 1939 deri në datën 9 maj 1945.
**6.** Shtetasve shqiptarë që janë ekzekutuar apo kanë vdekur në burgjet dhe kampet e përqendrimit nazifashiste, deri më 9 maj 1945, si dhe shtetasit shqiptarë, të cilët brenda 2 viteve nga dita e daljes nga burgjet apo kampet e përqendrimit nazifashistë, kanë vdekur si pasojë e plagëve apo sëmundjeve të ndryshme të marra në këto vende.
**7.** Shtetasve shqiptarë, pjesëtarë të formacioneve ushtarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë rënë në luftën kundër pushtuesve nazifashistë jashtë kufijve shtetërorë, deri më 9 maj 1945.
**8.** Shtetasve shqiptarë, pjesëmarrës në formacione të rregullta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë humbur jetën, brenda datës 9 maj 1947, për shkak të sëmundjeve dhe plagëve të marra ose fatkeqësive të ndryshme, duke qenë në krye të detyrës luftarake.
**9.** Shtetasve shqiptarë që kanë rënë duke luftuar në Spanjë (1936-1939) ose në vende të tjera, të inkuadruar në formacionet e koalicionit antifashist, deri më 9 maj 1945, ose që kanë vdekur brenda 2 vjetëve nga plagët ose sëmundjet e marra në këto luftëra.
**10.** Shtetasve të huaj, pjesëtarë të formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë.
**11.** Shtetasve të huaj, pjesëtarë të formacioneve të ushtrive aleate në Luftën e Dytë Botërore, në ndihmë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, që kanë humbur jetën brenda territorit të Shqipërisë.
**12.** Shtetasve shqiptarë që kanë rënë duke luftuar për pavarësinë e Kosovës, si dhe shtetasit shqiptarë të rënë për të drejtat kombëtare, në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan.
**13.** Shtetasve shqiptarë që bien në mbrojtjen e integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë, për mbrojtjen e institucioneve shtetërore nga terrorizmi ose në luftë kundër bandave të armatosura dhe kundër krimit ndaj jetës së individit.
**14.** Shtetasve shqiptarë që vriten nga elementë kriminalë, për shkak të detyrës shtetërore që kanë kryer në luftë ndaj krimit dhe përpjekjeve për vendosjen e rendit dhe qetësisë publike.
**15.** Shtetasve shqiptarë që bien në krye të detyrës, për mbrojtjen e paqes dhe të lirisë së kombit shqiptar, ose atyre që bien në krye të detyrës me misione në mbrojtje të paqes e të sigurisë së popujve të tjerë.
**16.** Shtetasve shqiptarë që humbin jetën në krye të detyrës, për mbrojtjen e pasurisë publike ose nga rreziqet e fatkeqësitë natyrore.
**17.** Shtetasve shqiptarë të vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990.
**18.** Shtetasve shqiptarë që kanë humbur jetën ose që humbasin jetën në përpjekje për të ndihmuar popullsinë në raste fatkeqësish natyrore apo që humbasin jetën në përpjekje për mbrojtjen e pronës publike ose për shpëtimin dhe mbrojtjen e jetës së individit nga krimi.
**19.** Shtetasve shqiptarë që vriten nga forcat apo elementë antishqiptar në mbrojtje të flamurit dhe simboleve kombëtare dhe manifestimit të ndjenjave kombëtare.
**20.** Shtetasve të huaj, pjesëtarë të formacioneve në ndihmë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë apo Policisë së Shtetit Shqiptar, që humbasin jetën në krye të detyrës, në ndihmë të popullsisë apo në përpjekje kundër terrorizmit ose krimit ndaj jetës së individit.
**21.** Shtetasve të huaj, pjesëtarë të formacioneve ushtarake të NATO-s, në ndihmë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që humbasin jetën në krye të detyrës, në mbrojtje të integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë.
**22.** Ekuipazhet që bien në krye të detyrës shtetërore gjatë fluturimit.

**NENI 6**

**Përjashtimi nga statusi "Dëshmor i Atdheut"**

Statusin "Dëshmor i Atdheut" nuk e përfitojnë personat, që janë dënuar me vendime gjykate të formës së prerë për krimet, si më poshtë:
**1.** Për krime kundër njerëzimit.
**2.** Për bashkëpunim me pushtuesit e vendit.
**3.** Për veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë.
**4.** Për vrasje me dashje, pas datës 9 maj 1945.

Prezantohet tarifa për aksin Milot-Morinë, 100 lekë për banorët e Kukësit dhe autobusët

# Rruga e Kombit, zbardhet skema lehtësuese për tarifat

## Shteti do t'i paguajë shtesë kompanisë edhe 48.5 mln euro

Ornela Manjani

Banorët e Kukësit do të përfitojnë vetëm për automjetet e klaseve A dhe B të regjistruara në këtë qark tarifë 100 lekë për 1 kalim, por kufizohet në jo më shumë se 44 kalime në muaj. Automjetet e mësipërme do të marrin falas pajisjen elektronike 'Telepass' dhe përmes saj do të bëjnë rimbushjen e vlerës së kalimeve mujore. Vlera e rimbushjes do të jetë e vlefshme për t'u përdorur brenda 1 muaji nga kryerja e pagesës.

**TAKIMI**

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj zhvilluan dje një takim me përfaqësues nga qarku i Kukësit, ku prezantuan paketën e negociuar me kompaninë koncesionare për skemën lehtësuese tarifore të kalimit në aksin Milot-Morinë për banorët e qarkut të Kukësit, mjetet e transportit publik dhe përdoruesit e shpeshtë, sipas një njoftimi zyrtar. Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues nga Prefektura e qarkut të Kukësit, nënkryetarë të Bashkisë së Kukësit e Tropojës dhe kryetari i Bashkisë Has, përfaqësues të këshillave bashkiake të këtyre tri bashkive, përfaqësues nga bizneset e qarkut të Kukësit dhe linjave të transportit. Paralel me procesin e negocimit me kompaninë koncesionare janë zhvilluar më shumë se 10 takime konsultative me komunitetin dhe grupet e interesit ku përfshihen: dëgjesa me banorët dhe drejtuesit e Bashkive të Kukësit, Hasit e Tropojës; takime me përfaqësues të Prefekturës dhe këshillave bashkiake; takime me përfaqësues të bizneseve të grupuara në Odën Ekonomike të Kosovës; takime me Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë. Grupi ndërministror, i cili ka negociuar me kompaninë koncesionare bazuar mbi këto kërkesa të grupeve të interesit dhe hapësirave buxhetore, ka arritur të përmbyllë paketën lehtësuese tarifore për komunitetin lokal. Grupi ka pranuar kërkesën e bizneseve (kryesisht atyre të Kosovës), për të spostuar rinisjen e zbatimit të kalimit me tarifë përtej sezonit aktual turistik. Rrjedhimisht, është përcaktuar që kalimi me pagesë në aksin Milot-Morinë të fillojë të zbatohet duke nisur nga data 17 shtator 2018. "Qeveria po merr riskun më të madh. Ne po marrim riskun financiar të zgjidhur një problem social, meqenëse Kukësi është zonë e varfër, është deri diku e izoluar, nuk ka rrugë të qenësishme alternative dhe jemi koshientë për këtë. Ne mendojmë që kjo punë të fillojë në shtator. Pra, kjo verë të kalojë duke dëgjuar edhe bizneset, pjesën e Kosovës. Nga 17 shtatori të fillojë të aplikohet tarifa. Këto favore për biznesin janë njësoj edhe për Kosovën. Pra, nuk kemi ndjekur parim diskriminues", nënvizoi ministri Gjiknuri. Më tej, ai tha se po vazhdon investimi për ta përfunduar segmentin nga Kukësi në Morinë, duke e sjellë brenda parametrave të duhura. "Ne do ta kompletojmë edhe pjesën e mbetur nga Kukësi në Morinë. Kanë filluar investimet aty dhe po rregullohen urat. Shumë shpejt do të mbyllet kontrata edhe për pjesën e mbetur dhe do të vendosim edhe 2-3 mbikalime aty, pasi është bërë zonë e rrezikshme për qytetarët. Pra, brenda vitit edhe ajo pjesë e mbetur e autostradës do të kompletohet me parametrat e duhura", theksoi Gjiknuri. Ndërkaq, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj tha se rruga paraqet vështirësi në mirëmbajtje dhe kosto të larta, por mbetet strategjike. "Ajo është rrugë sa e vështirë, edhe strategjike. Pse është e vështirë? Këndet gjeologjike gjeografike i ka të vështira, një pjesë e saj ngrin gjatë dimrit, ndërkohë që strategjikisht është mundësia e aeroportit të Kukësit. Ndërkohë nga ana strategjike, sigurisht që ka lidhje me qarkun e Kukësit, që është fatkeqësisht një nga qarqet më të varfra dhe me Kosovën", tha Ahmetaj. Më tej ai sqaroi efektin që ka në Buxhetin e Shtetit paketa lehtësuese e negociuar me kompaninë koncesionare. "Efekti shtesë bruto në Buxhetin e Shtetit për një vit, për pesë vitet që vijnë kap vlerën rreth 1.1 milionë euro, ose afërsisht 140 milionë lekë të reja. Të gjitha zbritjet që patë ju për qytetarët e Kukësit, për linjat, për përdoruesit e shpeshtë, shkojnë në 48.5 milionë euro. Dikush mund të thotë se pagesa është simbolike, dikush mund të thotë për mua është shumë, por kjo është situata e buxhetit. Kjo është situata e rrugës dhe kryeministri ka vendosur që Buxheti i Shtetit do të marrë këtë kosto, rreth 50 milionë euro vetëm për këtë zbritje të konsiderueshme", sqaroi Ahmetaj.



Ministrat Ahmetaj dhe Gjiknuri, gjatë takimit në Kukës

### EFEKTI FINANCIAR NË BUXHET

Shteti shqiptar duhet t'i paguajë koncesionarit në 30 vitet e kontratës 48.5 milionë euro si rezultat i zbatimit të këtyre tarifave të reduktuara për banorët e qarkut Kukës, mjetet e transportit publik në këtë zonë dhe përdoruesit e shpeshtë.

### PAKETA LEHTËSUESE PARASHIKON:

Tarifimi i automjeteve të banorëve të qarkut të Kukësit
Tarifë prej 100 lekë me TVSH për 1 kalim për të gjithë automjetet e regjistruara në qarkun Kukës.
Tarifa e reduktuar do të jetë e kufizuar për jo më shumë se 44 kalime në muaj dhe e vlefshme për t'u përdorur brenda periudhës 1-mujore nga data e kryerjes së pagesës për këto kalime.
Përdoruesit e qarkut Kukës do të parablejnë në mënyrë të përshkallëzuar deri në 44 kalime me këtë tarifë të reduktuar.
Kjo skemë tarifore do të aplikohet për klasën e automjeteve A dhe B për përdorim vetjak, të regjistruara në qarkun Kukës.
Automjetet e cilësuara më lart, të regjistruara në qarkun e Kukësit, do të marrin falas pajisjen elektronike "Telepass" dhe përmes saj do bëjnë rimbushjen e vlerës së kalimeve mujore sipas nevojës.
Tarifimi i autobusëve të linjës
Janë identifikuar 11 linja të licencuara autobusësh që kryejnë udhëtime nga dhe për në qytetin e Kukësit.
Për të eliminuar efektin e tarifës në koston e udhëtimit të banorëve të qarkut Kukës, këto linja do përfshihen në skemën preferenciale.
Këto mjete do të kenë tarifë kalimi prej 100 lekë me TVSH për 1 kalim.
Tarifimi i përdoruesve të shpeshtë të rrugës, pavarësisht vendosjes së tyre (kryesisht bizneset nga Shqipëria dhe Kosova)
Nga 20 deri në 30 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 10%.
Mbi 30 deri në 50 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 20%.
Mbi 50 deri në 60 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 30%.
Mbi 60 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 40%.

## Sejko: Zhvillimet e ekonomisë optimiste, kryesisht në turizëm

Mjedisi makroekonomik vlerësohet i qëndrueshëm dhe prospektet tregojnë për ruajtjen e ritmit pozitiv të rritjes së ekonomisë." Kështu u shpreh guvernatori Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, gjatë takimit me përfaqësues të Fondit Europian për Europën Juglindore, kryesuar nga Chistoph Tiskens. Duke u ndalur te zhvillimet e fundit të sektorit financiar dhe bankar në Shqipëri, Sejko tha se zhvillimet e ekonomisë janë optimiste, sidomos në sektorin e turizmit. Sa i takon sistemit bankar, sipas guvernatorit Sejko, ai shfaqet me tregues mjaft të mirë financiarë, likuid dhe është financiarisht i shëndetshëm. Ndërkohë, Tiskens vlerësoi mbështetjen e Bankës së Shqipërisë për çdo iniciativë të ndërmarrë nga EFSE. Shqipëria është edhe një nga vendet e para aksionare të EFSE-s. Sa i takon bashkëpunimit mes dy institucioneve, Sejko dhe Tiskens shprehën domosdoshmërinë për rritjen e aksesit në financa të sektorit të ndërmarrjeve të vogla. Sipas Sejkos, rritja e produktivitetit për këto të fundit ka një rëndësi të madhe për konvergjencën ekonomike të vendit, duke shtuar se BSH mirëpret kontributin e EFSE-s për uljen e kostove për alokimin e fondeve për këto ndërmarrje.


bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

**OPEN CALL FOR TENDER**
**PREQUALIFICATION**

1. **GENERAL CONDITIONS**

1.1 **Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1

1.2 **Profile:** The project IPA/2017 "Countering Serious Crime in the Western Balkans" (IPA2017 CSC WB) supports since January 2017 the Public Prosecution Offices (PPO's), Ministries of Justice, Ministries of Interior and police in Albania, Bosnia and Herzegovina (BiH), Kosovo*[1], Montenegro, Serbia and the former Yugoslav Republic of Macedonia. It is financed jointly by the European Commission and the Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (BMZ) and implemented by the GIZ, Italian Ministry of Interior and the Center for International Legal Cooperation (CILC Netherlands). The overall objective of the project is to improve the overall security in the Western Balkans and the EU by combatting organized crime and terrorism.
The specific objective of the Action is to raise the effectiveness of and cooperation among regional and national capacities in tackling occurring forms of Serious Organized Crime (SOC), including the recovery of illegal financial gains obtained through diverse types of cross-border crime and the fight against illegal migrant smuggling.

1.3 **Subject:** The objective of the present call is for selecting potential institutions and legal persons to provide training in English language with a focus on Legal English and specific English terminology used by state authorities in charge with fight against serious and organised crime. The courses will have to be provided to members of staff from GIZ partner institutions in Albania the IPA2017 CSC WB project including the State Police, the Serious Crime Prosecution Office (including the District Prosecution Offices of Tirana and Durres), the Ministry of Justice, and the Ministry of Interior.

The selected provider should be able to provide teaching at the premises of beneficiary institutions in Tirana and Durres for the period September 2018 to November 2019 and is expected to coordinate and harmonize its work with the IPA2017 CSC WB partner institutions.

1.4 **Eligibility:** Participation is open to all legal persons (participating either individually or in a grouping — consortium — of tenderers) which are effectively established in Albania.

All legal entities interested in the application process should ask for application forms to the address: giz-albanien@giz.de

2. The **due date** for submitting the application is **6 July 2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Provision of Special English Language Course Focused on Legal and Similar Terminology in Use by Crime-Fighting State Authorities" to:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1, Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated and only prequalified candidates will be invited to answer the bid. All written communication for this procedure and the following successful ones must be in English.

**(Footnotes)**
*This designation is without prejudice to positions on status and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of Independence.

TE DREJTAT E TE RINJVE

INTERVISTA

### Sekretari i Rrjetit Kombëtar të të Rinjve: Do të mundësojë reduktim të tarifave të shërbimeve

# Karta rinore ngel "peng" i neglizhencës së institucioneve

## *Flavio Dibra: Përfiton grupmosha 14-29 vjeç*

Voltiza Duro

*Prej më shumë se 10 vitesh, qeveritë e ndryshme kanë premtuar futjen në fuqi të kartës rinore nga e cila do të përfitojnë lehtësira rreth 210 mijë të rinj në vend. Por mesa duket, neglizhenca e institucioneve përgjegjëse ka bërë që kjo kartë të ngelet vetëm një ide e hedhur në letër. Kështu, aktivistët e Rrjetit Kombëtar të të Rinjve të Shqipërisë kanë organizuar protesta të ndryshme ku kërkojnë trajtimin e të rinjve me kartën rinore, ashtu si të rinjtë europianë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Flavio Dibra, sekretar i përgjithshëm i këtij rrjeti, njëkohësisht përfaqësues i studentëve të Fakultetit të Shkencave Sociale tregon të gjitha lehtësitë në shërbim që mund të kenë të rinjtë nga karta rinore. Dibra thekson se, nëse kjo kartë hyn në fuqi, parashikohet zerimi i tarifave të transportit publik; reduktim i çmimeve të librave e biletave të hyrjes në institucionet kulturore. Nga kjo kartë rinore do të përfitojnë të gjithë të rinjtë në Shqipëri nga mosha 14-29 vjeç, çka do të ndikojë në lehtësimin e jetesës për këtë kategori.*



Flavio Dibra, sekretar i përgjithshëm i Rrjetit Kombëtar të të Rinjve të Shqipërisë




Gjatë protestës së rrjetit kombëtar të të rinjve

**Si lindi ideja e krijimit dhe përhapjes së kartës rinore?**

Rrjeti Kombëtar për Të Rinjtë në Shqipëri ka marrë angazhimin prej disa vitesh për të lobuar për përhapjen dhe shpërndarjen e kartës rinore. Kjo e fundit është premtuar rreth 1 dekadë më parë për t'i siguruar të rinjve disa përfitime. Deri në 2015-ën, karta rinore ka qenë një premtim i pabazuar diku.

**Pra, pas vitit 2015-të, karta rinore u përfshi në dokumentet zyrtare të qeverisë?**

Ne kemi një dokument zyrtar të hartuar e firmosur nga kryeministri Edi Rama, i cili quhet plani kombëtar për të rinjtë, një plan strategjik, i cili përbën një objektiv për t'u arritur nga të gjitha politikat deri në 2020-ën. Në hartimin e këtij plani, një nga pikat sanksionon: "Karta rinore është një e drejtë rinore, e cila në këtë plan parashikohet që të këtë buxhetin e saj për t'u vënë në zbatim e për t'u përmbushur si pikë e një plani që të konsiderohet e ezauruar". Nga viti 2015 e deri më sot, është bërë vetëm një korrespondencë mes ministrisë, shoqatës Youth Act dhe organizatës që e ofron si shërbim kartën europiane rinore.

**Cilat janë përfitimet dhe lehtësitë që ofron karta rinore?**

Përfitimet e kartës rinore përfshijnë: uljen e çmimit të biletave në transportin publik dhe privat; reduktim i çmimit të biletave për hyrjen në institucionet kulturore si muze, teatër etj.; zbritja në pagesë të reduktuar në ambiente që shtojnë eksperiencën studentore apo rinore; ulje e çmimit të librave shkollorë dhe jashtëshkollorë. Transporti mund të zerohet absolutisht. Por reduktim i pagesave mund të realizohet edhe në mensa, sipas këtyre kartave. Kjo do të lehtësonte shumë jetesën e të rinjve në të gjithë vendin. Pra, ka një gamë të gjerë që kjo kartë studentore dhe rinore korelojnë me njëra-tjetrën.

"Rrethimi i Shkodrës" që njohim ne u shkrua më 1504 prej Marin Barletit. Tanimë, dy studiuesit Luçia Nadin e Aurel Plasari kanë gjetur në Bibliotekën Mazarin në Paris një dorëshkrim të kësaj vepre që mendohet se u shkrua prej Barletit mes viteve 1495 - 1501. Bëhet fjalë për një variant më të hershëm, me një titull disi më ndryshe, por për të njëjtën ngjarje historike. Dorëshkrimi latinisht, që ruhet në Bibliotekën Kombëtare të Francës, një kopje e të cilit pritet të vijë në Shqipëri, u prezantua dje në Tiranë nga dy profesorët në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Zbulimi rrëzon teori të tjera si ajo që gjente indicie të një kopjimi të mundshëm nga Barleti prej Beçikemit duke rikonfirmuar autenticitetin e Barletit si autor. Plasari tha "vepra është shkruar kur kishte shpërthyer kryengritja e Lezhës, jo siç e dinim ne që u shkrua në paqe. Ka teori që duhen kthyer përmbys. Barleti nuk ka marrë nga Beçikemi". Mbetet ende për t'u vënë përballë teksti i dy veprave që i kushtohen "Rrethimit të Shkodrës", me diferencë 4, 5 a 6 vjeçare mes njëra-tjetrës e nga i njëjti autor, për të parë tashmë se cili është ndryshimi mes dy dorëshkrimeve. "Vepra e parë, i kushtohet Dogjës së Venedikut që është në fuqi, ndërsa vepra e sapogjetur, i kushtohet Dogjës që ishte para tij", tha Plasari, e dhënë që është marrë për bazë për datimin e dorëshkrimit, pasi Dogja i dorëshkrimit të ri kishte ndërruar jetë, kur u bë dorëshkrimi i dytë, ai që njohim ne i vitit 1504.

Në këtë pikë, Luçia Nadin tha se duhet pak durim për të arritur në përfundime sa i takon veprës së sapogjetur të biografit të Skënderbeut. "Vepra nuk ka shumë shënime anësore, përveç faqeve të para, çka të lë të kuptosh se ky është një ekzemplar i përgatitur për botim. Duhet të them se teksti nuk është me komente. Duket pra më shumë një kopje luksi dhe jo një tekst që po shkruhej ndërkohë. Vepra ka tekst të pastër dhe këtë e them pasi ua kam dërguar për ta parë specialistëve të kaligrafisë. Është kopje e pastër. Teksti ka probleme edhe me fontin edhe nga këndvështrimi paleografik. Ka pasur qendra në Venecia që kopjonin, ndaj duhet parë nëse është shkruar nga vetë dora e Barletit apo në kancelaritë e Venecias", tha studiuesja veneciane që prej vitesh ka kushtuar studimet Shqipërisë duke mundur vite më parë të zbulonte për herë të parë "Statuset e Shkodrës".


*Në foto:* **Dorëshkrimi i Barletit, në rreth vula e mbretit të Francës**

Ndonëse është gjetur në fondin e Bibliothèque Mazarine (që i përket koleksionit të Kardinalit Jules Mazarin) në Paris pranë Bibliothèque Nationale de France, dorëshkrimi është shkruar ne Venecia. Për të sqaruar udhëtimin e veprës nga Venediku pranë Mbretit të Francës, Plasari si fillim hedh dritë mbi koleksionin e Kardinalit Mazarin, çka shërben për të kuptuar më tej, udhëtimin e dorëshkrimit të Barletit nga 'Italia' në Francë.

"Mazarini ishte një koleksionist i sëmurë. Koleksiononte piktura dhe dorëshkrime. Pjesa më e madhe e pikturave në Palais Royal, janë të kardinalit Mazarin. Ai kishte një kryebibliotekar të Risheljesë që e niste për 'gjueti' në Itali, Gjermani e kudo, për të kapur, dorëshkrime, vepra e botime të rralla".

Sqarimi i mësipërm duhet edhe për të kuptuar me qartë pse vepra mban stemën e mbretit të Francës. Plasari tha se stema që shihet mbi dorëshkrimin e fundit të 1400-ës, është e stema e Luigjit të XIV. "Mazarini i shërbeu Luigjit të XIV ndërsa të XV-it nuk jam i sigurt. Sigurisht është detaj i bukur që së bashku me Luçinë do ta sqarojmë në vijim, se si mund të ketë përfunduar në bibliotekën e Mazarinit. Sigurisht është e mundshme, sepse ishte i fuqishëm dhe ai merrte çdo dorëshkrim që donte".

**VULA E MBRETIT NË VEPRËN E BARLETIT**

Pas fjalës së Nadin dhe asaj të Plasarit, Thomas Frashëri, që po kujdeset për Konferencat me rastin e VMGJKS, kërkoi të bënte një ndërhyrje mes prezantimit të zbulimit dhe pyetjeve të audiencës së pranishme. "Është diçka pak personale duke qenë se kam punuar në Bibliotekën Mazarin në Francë, që ndodhet në godinën e pesë akademive, mes të cilave edhe të Akademisë Franceze. Koleksioni i Kardinalit Mazarin është një koleksion personal. Në testamentin që la para se të vdiste të gjithë librat e bibliotekës së tij ku numërohen 1 milion vëllime(nga 14 mijë të fillimit) ia la mbretit të Francës, Luigjit të XIV që e kishte nun të pagëzimit kardinalin Mazarin",-tha Frashëri. Mandej, ai bërë një ndalesë që hedh dritë mbi stemën e mbretit francez në dorëshkrimin e "Rrethimit të Shkodrës". "Për sa i përket stemës që gjendet e gjendur në vëllimin që ju treguat, mund të jetë e Luigjit të XV, por me shumë gjasa e Luigjit të XVIII. Për një arsye shumë të thjeshtë. Deri në revolucionin francez, stema e mbretit të Francës paraqitej e ndarë në dysh, sepse mbreti i Francës ishte edhe mbret i Navarës, dhe titulli zyrtar i mbretit të Francës ishte 'Mbret i Francës dhe i Navarës'. Deri më 1790-ën stema paraqiste tre zambakët e Francës dhe stemën e mbretërisë së Navarës që u zhdukën në heraldikën mbretërore franceze gjatë restaurimit më 1814-1815 kur Luigji i XVIII hipën në fron. Duke qenë se revolucioni francez i kishte shpërndarë koleksionet mbretërore siç shpërndau edhe bizhutë e kurorës, në kohën e Napoleonit, e sidomos në kohën e restaurimit të Burbonëve, të gjitha u mblodhën, u koleksionuan dhe u sistemuan, në atë që u bë më vonë Biblioteka Kombëtare e Francës, prandaj është edhe vula", tha Thomas Frashëri. Vërejti me këtë rast se edhe sot e kësaj dite, në shumicën e dorëshkrimeve në Bibliotekën Kombëtare të Francës është vula e Mbretit të Francës. "Them se ndoshta ka shanse, që Luigji i XV që kishte një sqimë të rafinuar vetë, i shumëdashuri, siç quhej, e ka përdorur me raste edhe stemën mbretërore të Francës dhe të Navarës. Ajo që është e sigurt është që stema mbretërore e Francës, e pastër me tre zambakët e artë në fushën e kaltër, është përdorur e plotë dhe e vetme vetëm duke filluar nga restaurimi i Burbonëve më 1814-1815 dhe u zhduk përfundimisht më 1830 kur Lui Filipi hoqi dorë nga trashëgimia e Burbonëve. Ky është një element që doja të ndaja me ju, duke qenë se kam punuar disi me heraldikën franceze, e që ndoshta mund të jetë një pikënisje për të vërtetuar lidhjen e këtij dorëshkrimi me një aspekt të veçantë",-përfundoi Frashëri.

Plasari e gjeti me interes të dhënën e Frashërit, duke parë në të një shteg për kërkime të mëtejshme sa i takon dorëshkrimit të rrethimit të Shkodrës.

Luçia Nadin tha se duhet pak durim për të arritur në përfundime sa i takon veprës së sapogjetur të biografit të Skënderbeut. "Vepra nuk ka shumë shënime anësore, përveç faqeve të para, çka të lë të kuptosh se ky është një ekzemplar i përgatitur për botim. Duhet të them se teksti nuk është me komente. Duket pra më shumë një kopje luksi

BLUE TOOTH
Thashetheme
MADE IN ALBANIA
Nr. 615
SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: **Pamela ALIAJ** - Art Designer: **Nevila Samarxhi**
E shtunë 23 Qershor 2018

**AFËRDITA DRESHAJ DHE JAKUB KINDL REALIZOJNË FOTOSESIONIN E PARË PARA DASMËS**



# ADEL LAMI:



**Modele, balerinë apo politikane? Do ju dal nga pritshmëritë**

**Rrëfehet balerina e DWS: Si e quaj Nikon me përkëdheli. "Jam shumë e vështirë për t'u joshur, pothuaj asgjë nuk më impresionon"**



# ENO POPI

## JA E VËRTETA E IKJES

*Moderatorë që braktisin televizionet, lëvizjet e shtatorit dhe programet që priten të nisin. Largohet nga emisioni i mëngjesit?*

• DAFINA ZEQIRI KA QENË NË DEPRESION: FAMILJA IME NUK E DI. • GATI PËR PUSHIME? ORINDA HUTA NISET, POR JO ME TURIN. • E KUQE SI KËSULËKUQJA, PROVOKUESE SI ELVANA. • KUR JASHTË BIE SHI, JONIDA MALIQI DO T'JU HABISË ME ATË QË BËN. • RIKE ROÇI IRONIZON POSTIMIN E EVA MURATIT. • S'KA SI FAMILJA! AURELA POSTON FOTOT E ËMBLA

## Rrëfehet balerina e DWS: Si e quaj Nikon me përkëdheli







## *Modele, balerinë apo politikane?*

# ADEL LAMI:

# Do ju dal nga pritshmëritë

## *"Jam shumë e vështirë për t'u joshur, pothuaj asgjë nuk më impresionon"*

*Ajo është padyshim një nga balerinat më të talentuara që ka spikatur shpesh në daljet e shpeshta në "Vizion Plus", sidomos në shown e njohur televiziv, "Dancing with the stars". Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Adel Lami, balerina që kërceu në krah të stilistit, Niko Komani, ka folur për shumë nga pasionet dhe aspiratat që kërkon të arrijë së shpejti. Adela na ka rrëfyer, gjithashtu, edhe për aspiratat që ka për t'u bërë një politikane ndryshe nga të tjerët në Shqipëri. Cili ka qenë propozimi më unik për Adelën? Zbulojeni në intervistën e mëposhtme.*




Pamela Aliaj

**Jeni një balerinë profesioniste që kërcen me shumë pasion. Si lindi dëshira për kërcim?**

Është dhunti mendoj më shumë se dëshirë. E konsideroj si një fat të zgjedhur për mua përpara se unë vetë të kisha një mundësi zgjedhje. Ama edhe nëse do mundja, nuk do e ndryshoja.

**Si ishte eksperienca me Nikon në Dancing with the stars?**

Një nga më të mirat. Jam kënaqur dhe e kam shijuar pafund. Njëri-tjetrin e quajmë "syri i ballit".

**Çfarë do të ndryshonit nga performancat nëse do të mundeshit?**

Ndonjëherë ndoshta do doja t'ia kisha bërë pak më të lehta kërcimet, siç i kanë pasur fundja shumë konkurrentë të tjerë, por e di që është thjesht një hipotezë,

sepse ego profesionale dhe vitet e mia të punës në fund të ditës nuk do ma lejonin këtë zgjedhje.

**Keni mbaruar shkollën për "Shkenca Politike" dhe do të zhvilloni një master në SHBA për këtë degë. Keni thënë më parë se do të donit të ishit kryeministrja e Shqipërisë. Çfarë do të sillnit të re dhe si do t'i bindit shqiptarët t'ju votonin?**

Adela është një njeri që nuk mendon brenda kutisë, një balerinë që nuk kërcen sipas rregullave (rregulla të cilat diktohen nga njerëz që nuk kanë kompetencën e profesionistit) dhe sigurisht një politikane që do shpresojë të dalë mbi pritshmëritë që kanë njerëzit në Shqipëri për politikën.

**Cili është pasioni tjetër i Adelës përveç kërcimit?**

Leximi, fitnesi dhe shoppingu.

**Së fundmi keni hapur një blog të quajtur "The bling babe". Çfarë do të sillni ndryshe nga blogjet e tjera dhe sa mendoni se do të influencojë tek ndjekësit tuaj?**

Në këtë website dua të flas më shumë mbi jetën time pasi marr pafund pyetje mbi lifestylin tim, produktet që përdor, firmat që vesh dhe librat që lexoj. Kështu që e mendova "The Bling Babe" si vendin e duhur për të përmbledhur gjithçka për të cilën ndjekësit e mi kanë nevojë.

**A keni patur ndonjë propozim joshës lidhur me kërcimin për të qenë pjesë e ndonjë produksioni? Për çfarë bëhet fjalë konkretisht?**

Ju kërkoj ndjesë, por ime më më ka ndaluar kategorikisht të tregoj çdo plan apo synim timin deri në kohën kur gjithçka të bëhet publike. Ç'të bëj? Mama është Zoti.

**Në një intervistë të mëparshme keni thënë që pretendoni të lidhni jetën me djalin e Trump ose një princ të Anglisë. Sa i rëndësishëm është posti apo gjendja ekonomike nga 1-10 tek një mashkull për Adelën?**

Kam qeshur me zë të lartë me këtë pyetje, faleminderit për këtë ndjesi, e para. E dyta, posti dhe mirëqenia e dikujt ka qenë dhe do mbetet gjithmonë në historinë e njerëzimit si një aset shumë i rëndësishëm i një qenie njerëzore, por në fund të ditës përpos gjithçkaje, Adela është një njeri që zgjedh dashurinë.















**Si mund ta përkufizoni një mashkull 'ideal' për Adelën? Cilat janë disa nga gjërat kryesore që ai duhet të ketë?**

Karakter, karakter, karakter. Një burrë që vepron dhe jo një burrë që flet. Kjo është primarja për mua, pastaj sigurisht vjen intelekti, zemërgjerësia, gjatësia ...etj., etj., etj.

**A keni patur ndonjë propozim të pazakontë dhe joshës nga ndonjë mashkull për të të pasur pranë? Si keni reaguar?**

Propozimi më i bukur, por jo i pazakontë ka qenë një surprizë me qirinj dhe lule në breg të detit. Jam shumë e vështirë për t'u joshur, pothuaj asgjë nuk më impresionon. Nëse një femër arrin t'i plotësojë vetes gjithçka për të cilën ka nevojë, dhe sigurisht ka në krahë një familje që e mbështet në çdo hap, e ka shumë të vështirë të impresionohet nga një mashkull mediokër.

**Ju pëlqen modelingu dhe shpesh vini provokuese në foto. A do të pranonit të pozonit nudo për një shumë të kënaqshme lekësh?**

Qenkërkam provokuese dhe nuk e ditkam. Për Vogue do e bëja.

**Përpara na pret një verë shumë e nxehtë. Ku keni planifikuar t'i kaloni pushimet?**

Los Angeles, Miami, përpos ditëve që kaloj në pishinat e New York-ut.

# Dafina Zeqiri ka qenë në depresion: “Familja ime nuk e di”




Duket se kohët e fundit çështja e çrregullimeve mendore po prek një masë të madhe të shoqërisë dhe nga kjo nuk mund të shpëtojnë edhe vip-at. Mesa duket, pjesë e saj ka qenë edhe këngëtarja e njohur Dafina Zeqiri. Ajo nuk e ka thënë drejtpërdrejtë këtë gjë, por kjo nënkuptohet. Dafina Zeqiri ka publikuar në ‘Instagram’ një shkrim të një artisteje amerikane, e cila ka rrëfyer se ajo çdo ditë praktikohet dhe kujdeset për shëndetin e saj mendor. Pas kësaj këngëtarja shqiptare ka thënë se familja dhe fansat e saj nuk e kanë menduar asnjëherë se e ka kaluar dhe ajo këtë gjendje. “Depresioni është real dhe mund të jetë i dukshëm. Flisni! Kujdesuni për njëri-tjetrin! Mos e merrni mirësinë për dobësi! Mos e merrni dashurinë, besnikërinë dhe suportin të garantuar! Ju dua me gjithë zemër!”,-ka shkruar këngëtarja shqiptare.



## Gati për pushime? Orinda Huta niset, por jo me Turin

Pas një sezoni të ngjeshur pune dhe transmetimi, më në fund pak relaks edhe për vip-at tanë. Bukuroshja Orinda Huta ka bërë gati valixhet dhe ende nuk e dimë nëse është fillimi i pushimeve apo jo. Por një gjë është e sigurte, në aeroport ajo nuk është me Turin, por me shoqen e saj të pandarë, Marcela Lati. Të jetë ky një udhëtim mes vajzash si pikënisje pushimesh?





## Meta ftesë në Presidencë ish-futbollisteve dhe familjeve të tyre

Presidenti Ilir Meta ka ftuar dje ne Presidence mjafton personalitete te sportit per te pare ndeshjen Zvicer-Serbi. Ne kete foto ai shfaqet me Rebeka Panon, gruaja e Panajot Panos dhe Ledio Panon ish- futbollist/ trajner (Djali i Panajot Panos).





**Moderatorë që braktisin televizionet, lëvizjet e shtatorit dhe programet që priten të nisin**



# Largohet nga emisioni i mëngjesit? Ja e vërteta e ikjes së ENO POPIT

Pamela Aliaj

Shumë ndryshime po ndodhin kohët e fundit nëpër mediat vizive lidhur me lëvizjen e shumë figurave të ekranit nëpër pozicione të ndryshme, si brenda dhe jashtë mediave. Para pak kohësh, në qendër të vëmendjes u vu moderator i njohur, Blendi Fevziu si dhe Turjan Hyska. Ky i fundit, në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" rrëfeu të gjitha planet që kishte lidhur me pozicionin e ri në Klan Plus. Ndërkohë që kësaj radhe nën lupën tonë është moderatori i njohur i TCH, Eno Popi, i cili mbiquhet ndryshe edhe "zëri i mëngjesit", në emisionin e mëngjesit në Top Chanel të cilin e drejton me Lindi Islamin. Ndërkohë që kohët e fundit dolën lajmet se Popi do të lëvizte nga emisioni i mëngjesit për të qenë moderator në një tjetër emision televiziv të quajtur "Kutia e Fundit" e cila është marrë si patentë në Top Chanel. Sipas burimeve për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Eno Popi do të largohet nga emisioni i mëngjesit për të qenë nën moderimin e emisionit të mbrëmjes, "Kutia e fundit", e cila më parë është drejtuar nga Enkel Demi. Ndërkohë që Eno nuk ka bërë ende asnjë prononcim lidhur me këtë lëvizje që pritet të bëhet. Nga ana tjetër të shumta do të jenë ndryshimet që do të shohim në shtator. Blendi Fevziu pritet të shkojë në TCH, edhe pse nuk e ka vendosur ende ta pranojë zyrtarisht. Jonida Shehu, ish-moderatorja e "Pasdite në Top Chanel" do të rikthehet në televizionin Klan, Turjan Hyskën do ta shohim nën rolin e drejtorit të përgjithshëm në Klan Plus si dhe moderatorin e një emisioni në Klan. Ndërkohë që mund të përmendim edhe lëvizje të tjera të moderatorëve të televizioneve si IN TV, ku Alfio me Indritin do të nisin së shpejti emisionin "Kripë, bukë dhe…" në një tjetër media vizive, si dhe Albi Iskaj që pritet të nis një eksperiencë të re në tv Klan. Këto janë disa nga rryma e ndryshimeve që pritet t'i shohim si rezultat të rikthyer në shtator. Pas një vere të nxehtë dhe disa pushimeve të mira, vip-at tanë do të vijnë të karikuar për të sjellë një eksperiencë të re!

















# Kur jashtë bie shi, Jonida Maliqi do t'ju habisë me atë që bën

Edhe pse është verë dhe jemi në ditët e fundit të qershorit, mesa duket, moti po bën lojëra. Ditët e fundit kanë qenë të tepërta reshjet e shiut dhe padyshim që shpëtimi ynë i vetëm është çadra. Por ka raste kur edhe s'kemi si shpëtojmë të papriturave të shiut. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me këngëtaren e njohur, Jonida Maliqi. Kur nuk ka çadër, ka mënyra të tjera për t'i shpëtuar shiut. Një mushama e madhe mund të jetë një opsion i mirë apo jo? Ka gjithmonë një zgjidhje për situata të vështira, siç na tregon edhe Jonida!

# "S'e di, ta marr për kompliment, apo?", Rike Roçi ironizon postimin e Eva Muratit

Një nga fotot që ka bërë xhiron në Shqipëri dhe kudo në botë dhe ka bërë shumë përshtypje ka qenë fotoja e ish-banores së 'Big Brother', Rike Roçi së bashku me kushërirën e saj duke bërë tifo për Kombëtaren. Para dy ditësh, këtë foto e ka risjellë në vëmendje figura më e rëndësishme e Liverpoolit, Jurgen Klopp, ku në qendër ishte fotoja e Rikes me mbishkrimin: "Ja pse i mungon Shqipëria botërorit". Ndërkohë që prezantuesja Eva Murati, e ka publikuar në profilin e saj këtë reagim duke shkruar: "Nuk di ta marr për kompliment, apo…". Por ky postim ka bërë që të reagojë vetë Riken, e cila nuk e ka pritur mirë. "T'i themi shoqes E.M të Tring (tani e zbulova kush është) që për kompliment duhet ta marrë foton time që ka publikuar në Story-n e saj. Unë për vete nëse shoh një femër të bukur dhe të mirë më bëhet qejfi",-përfundon Roçi. Nuk dihet nëse do të ketë një reagim nga Eva pas këtij postimi.












# S'ka si familja! Aurela poston fotot më të ëmbla nga pushimet me vajzat

Prej një jave tashmë shkëputje, këngëtarja Aurela Gaçe ka nisur pushimet në Turqi së bashku me familjen e saj. Ndërkohë që, edhe pse është duke u relaksuar, ajo ka dashur të ndajë me ndjekësit e saj copëza nga këto pushime. Vetëm dje ajo ka publikuar në rrjete sociale një foto mjaft të ëmbël ku shfaqet me vogëlushen e saj Grace që ka hipur mbi të në shezlong. Ndërkohë që në një foto tjetër shfaqet e vogla, Abigail, duke luajtur në rërë. Sa kujtime të bukura!








# Afërdita Dreshaj & Jakub Kindl

## realizojnë fotosesionin e parë para dasmës

Pamela Aliaj

*"Barbie dhe Ken më në fund martohen", këngëtarja poston fotot më romantike që keni parë*

Edhe pak ditë dhe do të kemi mundësinë, edhe pse nga larg, të shijojmë dasmën e parë madhështore për këtë verë të VIP-ave tanë. Në fund të këtij muaji, këngëtarja dhe modelja shqiptare do të kurorëzojë dashurinë me hokeistin çek Jakub Kindl. Përgatitjet për natën e tyre më të rëndësishme kanë nisur herët dhe momente të tilla i kemi parë nga dyshja nëpërmjet publikimit të disa imazheve në rrjete sociale. Dhe së fundmi ata kanë realizuar edhe një fotosesion, i cili nga pamjet e para duket të jetë i mahnitshëm. Në fotot e realizuara ata njëri-tjetrin tashmë e kanë cilësuar si burrë e grua. "A të thash që do të jemi perfeksion?", shkruan këngëtarja në nja nga fotot bardh e zi. Një fotosesion tepër romanik i çiftit vjen i postuar në 'Instastoryn' e këngëtares. Të dy duken shumë të dashuruar me njëri-tjetrin. "Barbie dhe Ken më në fund do të martohen", është një tjetër mbishkrim. Ndërkohë që këngëtarja Afërdita Dreshaj ka konfirmuar datën e martesës së saj që më parë. Bukuroshja shqiptare do t'i japë fund beqarisë më 29 qershor të këtij viti. Konfirmimin e ka bërë vetë jo në rrjetin social 'Facebook'. "Martesa po vjen, ruajeni datën 29 qershor 2018", ka shkruar Afërdita. Bukuroshja prej vitesh është e fejuar me hokeistin e famshëm çek. Pavarësisht se këngëtarja ka pasur edhe momente gjatë lidhjes së saj që herë shkoi mbarë e herë jo me çekun, dyshja duket se kanë vendosur të shkojnë përpara. Të gjithë presim me padurim ditën e saj kur do të shfaqet nuse. Një ditë për t'u radhitur me ditët e tjera unike të dasmave të VIP-ave shqiptarë.





















Dje në 'Deutsche Welle'

# A mund ta shpëtojë Shqipëria Merkelin si kancelare?

Nga Adelheid Feilcke, Volker Wagener

(Vijon nga faqja e parë)

...për Merkelin dhe për BE-në. Është vetëm një tezë, asgjë më shumë: Shqipëria si vend për strehimin e përkohshëm të refugjatëve. Presidenti i Këshillit Europian, Donald Tusk dhe kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz e kanë hedhur të parët idenë, që të krijohen qendra për azilkërkuesit në Europë, por jashtë BE-së. Zëdhënësi qeveritar në Vjenë, Peter Launsky-Tieffenthal konfirmoi për 'DW'-në, se ndërkohë ka bisedime për krijimin e një qendre të tillë, ndër të tjera edhe me Shqipërinë. Kurse Endri Fuga, drejtor për Marrëdhëniet me Publikun dhe këshilltar i Kryeministrit të Shqipërisë, përmes e-mailit i tha 'DË'-së, se nuk ka as kërkesë dhe as diskutime për këtë temë. Opozita në Shqipëri e interpreton ndryshe. Ajo e akuzon qeverinë se do të arrijë përshpejtimin e anëtarësimit në BE në këmbim të qendrave për refugjatët. Dhe ja se si mund të ndodhte:

**SITUATA AKTUALE**

Në itinerarin ballkanik vazhdon të ketë lëvizje përmes rrugëve tokësore. Refugjatët vijnë kryesisht përmes Detit Mesdhe, por ndërkohë Italia, Malta apo Greqia nuk janë më të gatshme t'i pranojnë njerëzit në masë. Ndërsa vendet e BE-së, e ndër to Gjermania, duan që t'i kthejnë azilkërkuesit e refuzuar. Ç'lidhje ka kjo me Shqipërinë?

**PSE SHQIPËRIA?**

Vendi i vogël ballkanik ndodhet përgjatë itinerarit të refugjatëve dhe po ashtu edhe në Mesdhe, prej nga kalon pjesa më e madhe e refugjatëve, që zbarkojnë me anije. Porti i Durrësit ka kapacitete të mjaftueshme për zbarkimin e kontingjenteve të mëdha të refugjatëve. Nga anijet që eskortohen prej 'Frontex'-it refugjatët mund të vendosen në tokën shqiptare për t'u regjistruar. Paskëtaj, ata që nuk konfirmohen se kanë vërtetë arsye për azil, mund t'i kthejnë direkt në vendet nga kanë ardhur. Ndërsa ata që kanë nevojë për mbrojtje dhe potencialisht kanë të drejtë azili, mund të shpërndahen në vendet e BE-së.

Ajo që është atraktive për vendet e BE-së: Shqipëria nuk bën pjesë në BE. Atje nuk janë në fuqi rregulloret e BE-së si Marrëveshja e Shengenit apo Marrëveshja e Dublinit. Shqipëria është megjithatë, një vend anëtar në NATO e kësisoj, e ankoruar në aleancën e sigurisë së shteteve perëndimore. Përveç kësaj, në Shqipëri po ndërtohet aktualisht një Qendër Antiterror e NATO-s. Kësaj i shtohet edhe pozita e favorshme gjeografike, që veriu i Shqipërisë është i rrethuar prej maleve të larta, çka krijon një siguri natyrore të kufirit.



**A ËSHTË SHQIPËRIA E PËRGATITUR?**

Shqipëria ka përvojë të madhe me strehimin dhe trajtimin e refugjatëve. Në vitet 1998-1999 vendi strehoi gati një milion kosovarë. Dhe si rrjedhojë e krizës së refugjatëve në vitin 2015 në Shqipëri u krijuan kapacitete të konsiderueshme për pranimin e migrantëve. Këto kapacitete praktikisht kanë qenë deri sot të pashfrytëzuara. Në mediet e Shqipërisë bëhet fjalë për kapacitete në një shifër prej disa mijëra.

Zëdhënësi i UNHCR-së për Evropën Juglindore, Neven Crvenkovic, tha për 'DË'-në se prej vitit 2017 Shqipëria i ka dyfishuar kapacitet ekzistuese. Ndërkohë ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Fatmir Xhafaj, ka pasur këto ditë bisedime me homologë të tij në kryeqytetet e Evropës. Të enjten ai ishte në Berlin dhe një nga temat e bisedimeve ishte edhe migrimi.

**PSE DO T'I SHKONTE KJO PËR SHTAT EVROPËS?**

Ndryshe nga Libia, Shqipëria është një vend i sigurt në Evropë dhe pranë portave të BE-së. Përveç kësaj, Shqipëria kërkon të bëhet anëtare e BE-së dhe prandaj është e gatshme që të respektojë standardet e BE-së, si ato që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. UNHCR-ja konfirmon se Shqipëria i trajton mirë refugjatët në vend.

Të gjitha këto pika që Libia, e cila është po ashtu në diskutim, nuk i plotëson. Dhe mbi të gjitha, BE-ja nuk mund të veprojë aty si fuqi rregullatore, sepse Libia është një shtet pa strukturë dhe udhëheqje.

**Ç'PËRFITIM DO TË KISHTE ANGELA MERKELI PREJ KËSAJ?**

Ministri i Brendshëm gjerman, Horst Seehofer tha në takimin e tij të fundit me kancelarin austriak se ai mbështet idenë e qendrave të migrimit jashtë BE-së. Zëdhënësi i qeverisë gjermane, Steffen Seibert, nga ana tjetër, nuk donte ta komentonte të mërkurën këtë gjë për shkak të samitit të posaçëm të BE, i parashikuar për të dielën në Bruksel.

Një marrëveshje e mundshme me Shqipërinë do të kishte rëndësi të jashtëzakonshme edhe për çtensionimin e mospajtimeve të brendshme gjermane: Shqipëria do të ofronte zgjidhjen "humane". Dhe kërkesat e sigurisë të Seehofer-it: procedura të kontrolluara nën mbikëqyrjen e BE-së, por jashtë BE-së, do të bëheshin të mundshme. Horst Seehofer mund të jetë i kënaqur dhe ta shesë këtë si një sukses për fushatën zgjedhore bavareze. Kriza qeveritare pra faktikisht do të përfundonte.

"Zgjidhja shqiptare" mund të jetë e dobishme edhe për Shqipërinë: qeveria socialiste në Tiranë është nën presion nga qarqet konservatore, veçanërisht CDU-ja. Rekomandimi për samitin e BE-së për të hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë është vënë në pikëpyetje për shkak të shqetësimeve lidhur me sundimin e ligjit. Shqipëria mund të kërkojë si këmbim për marrëveshjen e refugjatëve dritë të gjelbër për bisedimet. Vendet e BE-së do t'ia shpërblenin me mirënjohje Shqipërisë një zgjidhje të tillë për krizën e migracionit. Një zgjidhje e artë krejtësisht sipas proverbit ballkanik "mishi të piqet, helli të mos digjet". Sepse me një zgjidhje shqiptare mund të mbeteshin të gjithë të kënaqur: BE-ja, Shqipëria, Angela Merkel dhe Horst Seehofer.

Opinioni i Ditës

# Shqipëria duhet të qëndrojë në anën e drejtë të historisë

Nga Namik Kopliku

*(Vijon nga faqja e parë)*



...Bashkimin Evropian, për të arritur mirëqenie ekonomike dhe zgjerimin e demokracisë. Megjithatë, populli shqiptar ka dëshmuar në historinë dhe kulturën e tij se nuk qëndron indiferent ndërsa popujt e tjerë vuajnë. Siç ka thënë Martin Luther, "padrejtësia kudo, është kërcënim për drejtësinë gjithandej".

Prandaj, ne nuk mund të injorojmë çfarë po ndodh në të gjithë globin dhe kërcënimet ndaj drejtësisë dhe lirisë në vende të tjera të botës. Në vitet e fundit, fundamentalizmi islamik dhe ekstremizmi kanë kërcënuar paqen dhe sigurinë në botë. Prej disa vitesh, në Irak, Jemen, Siri dhe Liban, miliona kanë vuajtur drejtpërdrejt nga efektet e ekstremizmit, veçanërisht fëmijët. Vetëm në Siri, mbi gjysmë milioni fëmijë të pafajshëm, gra dhe burra janë therur e vrarë brutalisht dhe miliona të tjerë janë larguar apo përzënë nga shtëpitë e tyre dhe kanë marrë strehim në vende të tjera.

Me mbështetjen e Teheranit, regjimi i Bashar al-Assad ka lëshuar armë kimike kundër popullit të pambrojtur të Sirisë. Vendet e Evropës, duke përfshirë Ballkanin, nuk janë të imunizuar nga kërcënimet e ekstremizmit. Kur Ayatollah Khomeini, themeluesi i Republikës Islamike, erdhi në pushtet në Iran, regjimi i tij ringjalli rrënjët e ekstremizmit dhe fundamentalizmit, të cilat ishin refuzuar dhe harruar nga populli i rajonit. Dhuna dhe terrorizmi u bënë armët kryesore të ekstremizmit kundër demokracisë. Bashkësia ndërkombëtare shpreh shqetësimin për ndikimin dhe ndërhyrjen e Republikës Islamike në vende të tjera.

"Regjimi iranian karburantizon dhunë, gjakderdhje dhe kaos në të gjithë Lindjen e Mesme", tha para pak ditësh presidenti i SHBA Donald Trump në një konferencë shtypi në Shtëpinë e Bardhë. "Kudo ku të ndodheni në Lindjen e Mesme, kudo që ka një problem, Irani është atje."

Administrata Trump tani është në krye të një koalicioni ndërkombëtar kundër ndërhyrjes së regjimit iranian në vendet e tjera, raketave balistike dhe ambicieve bërthamore të tij, si dhe trajtimit mizor të popullit të vet. Disa shtete të Evropës dhe Lindjes së Mesme janë bashkuar me këtë koalicion. Si një vend me një histori të gjatë nën diktaturë, Shqipëria mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë koalicion. Teherani po shpenzon miliarda dollarë nga xhepat e popullit iranian për të mbështetur grupet terroriste në Lindjen e Mesme, Amerikën Latine, Evropë etj. Mullahët që kanë pushtetin në Iran eksportojnë terrorizmin dhe paqëndrueshmërinë në vende të tjera për të ruajtur sundimin e tyre. Shumë zyrtarë të lartë iranianë, duke përfshirë liderin suprem Ali Khamenei, kanë pranuar se, nëse nuk do të kishte qenë ndërhyrja terroriste e regjimit të tyre në vende të tjera, ata do të luftonin për mbijetesë në rrugët e qyteteve të Iranit.

Maryam Rajavi, një grua muslimane që beson në tolerancë, aktualisht është duke udhëhequr koalicionin më të madh dhe më të shquar të opozitës iraniane kundër mullahëve të Iranit. Në një fjalim të vitit 2007, Rajavi theksoi se kërcënimi i ekstremizmit dhe ndërhyrjes së Iranit në Irak dhe në vende të tjera është shumë më i rrezikshëm sesa programi i tij bërthamor.

Kjo deklaratë vjen përtej faktit që lëvizja e znj.Rajavi ishte partia e parë që zbuloi programin e paligjshëm bërthamor të regjimit iranian në vitin 2002 dhe që atëherë është një burim i besueshëm informacioni rreth aktiviteteve bërthamore dhe terroriste të regjimit. Megjithatë, politika e Perëndimit me synim zbutjen e qëndrimit dhe afrimin me regjimin iranian i mundësoi Teheranit që të filtrojë terrorizmin e tij në vende të tjera.

Komponenti kryesor i opozitës iraniane është Organizata e Muxhahedinëve të Popullit të Iranit (PMOI / MEK). Një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të MEK u zhvendosën nga Iraku në Shqipëri si rezultat i një marrëveshjeje midis Uashingtonit dhe Tiranës. MEK gëzon mbështetje të madhe nga figura të shquara politike, udhëheqës fetarë, juristë dhe veteranë ushtarakë anembanë botës, veçanërisht në Evropë dhe në SHBA. John Bolton, këshilltari për sigurinë kombëtare i Presidentit të SHBA Donald Trump, senatori John McCain, ish-kryebashkiaku i Nju Jorkut Rudy Giuliani janë midis disa figurave politike që kanë udhëtuar për në Shqipëri për t'u takuar me udhëheqjen e MEK.

Në mjaft intervista me median shqiptare, shumë prej këtyre personaliteteve kanë shprehur mbështetjen e tyre për MEK dhe znj.Maryam Rajavi, si alternativë demokratike ndaj sundimit autokratik të qeverisë së mullahëve në Iran. Në intervistat e tyre me mediat shqiptare, Bolton, Giuliani dhe shumë të tjerë kanë konfirmuar kapacitetin e MEK-ut për ndërtimin e një demokracie laike në Iran.

Shqiptarët janë krenarë për mbështetjen që i japin popullit iranian dhe lëvizjes së tyre të rezistencës për liri. Ata e konsiderojnë mbështetjen për demokracinë në Iran si një detyrë dhe një qëndrim që do ta vendosë popullin dhe qeverinë shqiptare në anën e drejtë të historisë.

*Bashkë-kryetar i shoqatës së miqësisë së popullit shqiptar me MEK

## HOROSKOPI

### DASHI

Mëngjesin do ta keni të zënë me punë, fitime dhe shpenzime, por duke filluar nga orët e pasdites, me ndikimin e Hënës, çdo gjë do të ndryshojë në qiellin tuaj të brendshëm. Do të kaloni një mbrëmje të këndshme me miqtë apo vetëm me partnerin.

### DEMI

Do të jeni në formë shumë të mirë, nën ndikimin e Hënës së Ajrit, që fryn mbi zjarrin e Marsit dhe Uranit. Çfarë është thënë, është bërë! Do jeni plot gjallëri dhe të fuqishëm gjatë ditës, por të rraskapitur në mbrëmje. Nuk është vetëm lodhje, ajo është edhe ndryshimi i Hënës.

### BINJAKET

Mëngjesi nis i zymtë, por humori do t'ju rikthehet gjatë pasdites nga Hëna, duke ua bërë pjesën tjetër të ditës më romantike. Me partnerin tuaj do të keni harmoni. Edhe këtë herë do të mbyllni një sy ndaj defekteve të vogla të partnerit.

### GAFORJA

Hëna mike ju mbështet gjatë gjithë mëngjesit, duke bërë që të përqendroheni në komunikimin dhe fitim. Do të keni jetë sociale intensive dhe të përmbushur. Me një agjendë kaq të mbushur me kontakte dhe takime, nuk mund të humbisni asnjë minutë.

### LUANI

Gjatë gjithë mëngjesit do të jeni të ngarkuar me shumë projekte dhe do të bëni shumë punë, por pa arritur rezultatin e dëshiruar. Nga ana tjetër, mbrëmja do të jetë e qetë, ndërsa Hëna nxit një miqësi që të kthehet në diçka më shumë.

### VIRGJERESHA

Do të kaloni një ditë të hareshme me miqtë dhe do të keni bashkëpunim të ngushtë me kolegët. Do të jeni të sjellshëm dhe të edukuar me të gjithë që takoni sot. Ndërkaq, në mbrëmje do të ndjeni t'ju mbërthejë lodhja aq shumë, sa do t'ju zërë gjumi ndërsa shikoni një film.

### PESHORJA

Do të ndërmerrni projekte dhe investime të rëndësishme, por me kusht i që të kryhen në kohën e duhur, në të kundërt mund të mos arrini rezultatet e duhura. Veproni gjithmonë me logjikë: asnjë veprim i detyruar nuk të çon drejt suksesit.

### AKREPI

Do të keni ditë të mrekullueshme përderisa Hëna është në anën tuaj dhe më pas gjatë ditës do të bëjë që të jeni më entuziast dhe më të hareshëm. Shijojeni këtë të ditë sa më shumë të mundeni dhe mos e lini t'ju ikë.

### SHIGJETARI

Gjatë mëngjesit do të jeni tërësisht të zhytur në punë, pastaj gjatë pasdites, me ndryshimin e Hënës, do të jetë partneri që do t'jua marrë të gjitha energjitë. Mbrëmjen do ta kaloni të qetë, pasi të keni mposhtur lodhjen me dashuri.

### BRICJAPI

Kini kujdes që të mos nënshkruani kontrata që nuk ju përshtaten. Në lidhje me një çështje delikate kërkojini ndihmë një kolegu me më shumë përvojë, i cili do t'ju mbështesë. Për sa i përket jetës në çift, sot partneri do të jetë në qendër të vëmendjes.

### UJORI

Mosmarrëveshjet e mëngjesit në familje do të zgjidhen nga pasditja. Paqja do të nënshkruhet para një akulloreje të shijshme, me ngjyra të ndezura, ashtu si personaliteti i juaj i hareshëm.

### PESHQIT

Gjatë ditës mendoni për dashurisë dhe gjatë natës mendja juaj krijuese përpunon ide të shkëlqyera, të cilat kanë zbatim të vazhdueshëm. Dhe më e bukura është se ndiheni në formë, edhe pse keni sforcim të trupit dhe mendjes gjatë veprimtarisë suaj.

## Kutinjo e Nejmar vulosin suksesin

# Brazili, fitore në frymën e fundit me Kosta Rikën



Brazili fiton në frymën e fundit me Kosta Rikën, por siguron një tre pikësh që e vendos si favorit për të kaluar grupin. Të besuarit e Tites kanë vajtur shumë përballë amerikano-qendrorëve, që kanë bërë çmos për të dalë me pikë nga kjo përballje dhe që do t'u mbante gjallë shpresat e kualifikimit. Ndeshja ka ritëm, por është edhe e rrëmujshme dhe Brazili shfaqet konfuz në fazën ofensive. Kosta Rika prodhon rastin e parë të ndeshjes, kur në minutën e 13-të, kur Gamboa fton në gjuajtje Selso Borgez, që i jep më shumë kënd se ç'duhet gjuajtjes. Në të 26-ën Brazili do të shënojë, por gjithçka do të anulohet për pozicion jashtëloje të Gabriel Zhezus. Pjesa e parë mbyllet pa gola, ndërsa në të dytën do të nisë edhe rrethimi i zonës së Kosta Rikës. Në të 49-ën Gabriel Zhezus gjen vetëm traversën e Kejlor Navas, ndërsa në aksionin që vijon, është i pafat Kutinjo, me topin që devijohet aq sa të mos shkojë në rrjetë. Pak çaste më vonë provon Nejmar të realizojë, por topi del pak sipër traut. Sërish i pafat asi i PSG-së, kur sheh të djathtën e tij të mos gjejë rrjetën. Në minutën e 78-të vjen një nga episodet më të rëndësishme të ndeshjes. Nejmar bie në zonë dhe mashtron gjyqtarin Kuipers, që akordon penallti, por ndërhyn VAR-i dhe kthen pas vendimin e kryesorit holandez. Pas një beteje të vazhdueshme me Kejlor Navasin, më në fund pentakampeonët arrijnë të shënojnë me Kutinjon, që e kalon topin mes këmbëve të kostarikanit. Gëzimi është i madh te Brazili, aq sa Tite nuk përmbahet dhe rrëzohet në fushë. Duket se ndeshja është vulosur, por në shtesë do të ketë një tjetër gol. Nejmar shënon pas asistit të Dagllas Kostës dhe vë në kasafortë trepikëshin e parë në këtë Botëror, ndërsa kualifikimin duhet ta vulosin në ndeshjen e fundit me Serbinë, ku do të mjaftonte dhe një pikë.

### Zvicra ka shanse të mëdha për kalimin e grupit. Kundër Kosta Rikës do t'i mjaftojë barazimi



Jeton Selimi

# Xhaka e Shaqiri thyejnë Serbinë! Shqiptarët nderojnë Zvicrën

## *Mitroviç shënon i pari, përmbysin shqiponjat*

Ishte një fitore nga ato që do mbahen mend gjatë, një fitore shqiponjash me Granit Xhakën e Xherdan Shaqirin, që ndëshkuan Stojkoviçin për ta bërë Zvicrën të fluturojë në krye të grupit bashkë me Brazilin. Një fitore me përmbysje nga dy majtoshë, e arritur në pjesën e dytë, kur Graniti siluroi nga distance dhe më pas Xherdani rendi si maratonomak për të bërë të gëzojnë mijërat e zviceranëve në stadium, dhe të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Serbia e nis ndeshjen në mënyrë të frikshme. Ballkanasit kërkojnë dhe gjejnë gjithnjë në zonë Aleksandër Mitroviç, që në këto minuta të para është një alarm në zonën helvete. Mitroviç detyron Zomerin të grushtojë në këndore, ndërsa pak sekonda më pas me kokë përshëndet rrjetën e Zvicrës, duke shënuar një gol të shkëlqyer. Pas këtyre sulmeve asfiksuese të serbëve, përpiqet të reagojë Zvicra, që mund të kishte bërë dëm me Xhemajlin, që gabon fatalisht përpara portës së Stojkoviçit.



Zvicra nis të kontrollojë fushën, por rreziku qëndron në këmbët e Mitroviç, që në rove-shatë gjuan jashtë. Në minutën e 31-të Zvicra do të krijojë një rast të artë goli, por Seferoviç nuk do të devijojë siç duhet, duke i dhënë mundësi Stojkoviçit të shmangë një gol të sigurt. Serbia do t'i mbyllë 45 minutat e para në sulm, por pa prodhuar tjetër gol, ndërsa në pjesën e dytë janë helvetët ata që e nisin ndeshjen më mirë dhe konkretizojnë më shpejt. Minuta e 52-të dhe Granit Xhaka siluron Stojkoviçin atje ku gardiani i Partizanit të Beogradit nuk mund të arrijë dot. E majta e Xhakës është e hidhur, potente dhe sjell barazimin e dëshiruar për helvetët, ndërsa shqiptari shpërthen në festë, duke bërë dhe gjestin e famshëm të shqiponjës. Zvicra provon të shfrytëzojë momentin e mirë të saj, ndërsa Shaqiri bën një gjuajtje fantastike me të majtën, që e shtang Stojkoviçin, por godet vetëm shtyllën e jashtme. Kundërpërgjigjet Serbia me harkimin e hidhur të Kolarovit, por Mitroviç nuk arrin për pak centimetra. Fundi i ndeshjes është dramatik. Serbia kërkon e pashpresë të barazojnë, ndërsa Zvicra krijon mundësi radhazi shënimi derisa konkretizon një kundërsulm perfekt me Xherdan Shaqirin. Gjilanasi i shpëton pozicionit jashtëloje dhe vrapon si i çmendur drejt zonës serbe. Gjuan me të majtën dhe mposht Stojkoviçin duke i dhuruar Zvicrës një fitore të madhe, një fitore që e afron me kualifikimin, një fitore e ardhur nga shqiptarët, të cilët arritën t'i sigurojnë helvetëve shanse të mëdha për kalimin e grupit.

## Musa me dy gola heroi i ndeshjes

# Fitorja e Nigerisë, buzëqesh Argjentina

Nigeria befason Islandën dhe arrin një sukses shumë të rëndësishëm duke mposhtur ishullorët me shifrat 2-0, falë një Ahmed Musa stratosferik, që në pjesën e dytë praktikisht çmontoi mbrojtjen vikinge. Në fakt, ndeshja është me dy fytyra. Në pjesën e parë kemi një dominim të skuadrës së drejtuar nga Hallgrimson, që e nis me një mundësi të mirë me Sigurdson që nuk i jep forcë gjuajtjes së tij. Ishullorët janë më prezentë në shkëmbimet e para të topit, ndërsa Nigeria në këtë pjesë loje do të shfaqet vetëm në minutën e 8-të, kur Omeruo gjuan me kokë, por pret Halldorson. Pjesa e dytë do të jetë një tjetër muzikë dhe kësaj radhe dirigjentë janë afrikanët. Në të 49-ën Moses shpërthen në të djathtën dhe kroson në zonë, ku Musa kontrollon mjaft mirë dhe befason Halldorsonin. Vikingët përpiqen të ndryshojnë diçka në lojën e tyre, por duket se janë befasuar tërësisht nga Nigeria, që fillimisht do të shkundë traversën e Halldorsonit me anë të Ahmed Musa, ndërsa pak sekonda më pas sërish Musa bëhet protagonist me daljen në të majtë, vallëzimin në zonë, dhe rrjetën e tundur për rezultatin 2-0. Islanda nuk u beson syve, aq sa edhe kur gjyqtari zelandez Konger akordon penalltinë pas ndërhyrjes së VAR-it, Gylfi Sigurdson e shpërdoron, duke nxjerrë jashtë mundësinë e fundit për t'u rikthyer në ndeshje, ndërsa Nigeria kontrollon me qetësi deri në fund, duke siguruar një tre pikësh me shumë vlera në prag të takimit me Argjentinën, e cila pas suksesit të Nigerisë, është ka rritur shumë shanset e saj për kualifikim, kualifikim që do ta ndajë me afrikanët në sfidën e tretë të grupit.

PRAGNDESHJE

# Lwv, gati për fitoren e parë, Suedia s'ka frikë



Gjermania stonoi në ndeshjen e parë, ndërsa Joakim Lwv deklaron se lojtarët e tij janë gati të japin më të mirën në fushë. "Lojtarët e kanë treguar se janë gati gjatë seancave stërvitore të kësaj jave. Problem kemi Humelsin, që nuk do të jetë i gatshëm. Kjo është një ndeshje vendimtare për ne, duhet të shfaqim lojën tonë më të mirë dhe të reagojmë ashtu siç duhet". Nga ana tjetër, Jane Anderson mendon se Suedia e tij nuk është deficitare në eksperiencë përballë Gjermanisë dhe se lojtarët janë mësuar të përballojnë presionin. "Pavarësisht asaj që thuhet, nuk kemi deficit eksperience krahasuar me Gjermaninë. Kemi mundur të eliminojmë Italinë në play-off. Nuk kemi përse të ndihemi në disavantazh. Kemi treguar se dimë ta përballojmë presionin, por nuk duam të shfaqim arrogancë".





**Me Cash Plan ju përfitoni:**

- **Mbulim** të shpenzimeve mjekësore
- **Kontroll të vazhdueshëm** të shëndetit tuaj
- **Kartë** personale sigurimi
- **Shërbime mjekësore** në të gjithë rrjetin mjekësor me të cilin SiCRED bashkëpunon
- **Përkujdesje dhe asistencë** e pakufizuar nga një ekip profesional

**8 PAKETA STANDARDE PËR SIGURIMIN E JETËS**

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Në duar të sigurta!